




REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Ministria e Punëve të Jashtme
Ministarstvo Inostranih Poslova - Ministry of
Foreign Affairs

AKADEMIA DIPLOMATIKE
Diplomatska Akademija - Diplomatic Academy



UNIVERSITETI I PRIZRENIT
"UKSHIN HOTI"

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT

në mes të

AKADEMISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

dhe

UNIVERSITETIT TË PRIZRENIT "UKSHIN HOTI"

Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" dhe Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës pajtohen të nënshkruajnë Marrëveshjen e Mirëkuptimit me qëllim të bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të përvojave në fushën e diplomacisë dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare, të drejtës ndërkombëtare dhe të disiplinave të tjera akademike.

Neni 1.

Qëllimi

Universiteti i Prizrenit dhe Akademia Diplomatike do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e ligjëruesve, ofrimin e ligjëratave në lëmin e diplomacisë, të drejtës ndërkombëtare, historisë moderne politike, si dhe në studimin dhe hulumtimin e temave me interes të përbashkët. Të dy institucionet do të bashkëpunojnë reciprokisht dhe do t'i ofrojnë njëra tjetrës ndihmën e duhur gjatë organizimit të ngjarjeve me interes të përbashkët.

Neni 2.

Bashkëpunimi

Të dy palët e marrëveshjes janë pajtuar që të ofrojnë ligjërata, konferenca dhe seminare për kandidatët me tema me interes të përbashkët në hapësirat e Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" dhe të Akademisë Diplomatike të Republikës së Kosovës.

Neni 3.

Ofrimi i Ligjëruesve

Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" do të ofrojë ligjërues nga Fakulteti Filozofik, Fakulteti Juridik, Fakulteti Filologjik dhe Fakulteti Ekonomik. Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës do të sigurojë ligjërues nga radhët e trupit diplomatik të akredituar pranë Republikës së Kosovës, nga radhët e diplomatëve të Republikës së Kosovës, si dhe nga institucionet simotra ndërkombëtare.

Neni 4.

Publikimi i Punimeve

Të dy institucionet do të lehtësojnë publikimin e punimeve nga të dy partnerët në organet respektive institucionale, si dhe të teksteve me interes nga institucione të tjera publike apo private, qofshin ato vendore apo ndërkombëtare.

Neni 5.

Shkëmbimi i Informacioneve

Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" dhe Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës do të shkëmbejnë informacione me interes të përbashkët, përfshirë edhe pjesëmarrjen e përbashkët ose vetanake në takimet apo konferencat ndërkombëtare.

Neni 6.

Statusi

Ky dokument përbën marrëveshjen e plotë në mes palëve. Marrëveshja nuk konsiderohet kontratë obliguese financiare, ajo është dizajnuar për efekt të avancimit, bashkëpunimit dhe zhvillimit institucional të dy palëve.

Neni 7.

Hyrja në fuqi, Zgjatja dhe Përfundimi

Marrëveshja e Mirëkuptimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi për pesë vite. Marrëveshja mund të ndërpritet nga njëra prej palëve nënshkruese pas paralajmërimit me shkrim së paku 120 ditë para ndërprerjes. Aktivitetet e filluara para kërkesës me shkrim për ndërprerje të marrëveshjes, do të përfundohen sipas planit në kuadër të afatit kohor prej 120 ditësh, përveç rasteve kur palët pajtohen për të marrë vendim tjetër.

Marrëveshja mbetet në fuqi në mënyrë automatike edhe për pesë vite tjera, nëse palët nuk fillojnë procedurën e ndërprerjes së kësaj marrëveshjeje.

Në Prizren, më 3 mars 2014.

Në Prizren, më 3 mars 2014.

Për: Akademinë Diplomatike
të Republikës së Kosovës

Për: Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti"

Drejtor
Skender Durmishi

U.D. Rektor
Prof. Dr. Zahadin Shemsidini

